28 nëntor 2025

[Seancë e hapur]

[Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

[Të akuzuarit paraqiten përmes videolidhjes]

[Të akuzuarit Kilaj dhe Fazliu hyjnë në sallën e gjyqit]

--- Seanca fillon në orën 09.30

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Sekretare, paraqisni lëndën, ju lutem.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2023-10, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëmëngjesi të gjithëve në sallë të gjyqit dhe jashtë, dhe atyre që janë të lidhur përmes videolidhjes.

A mund të prezantohen palët duke filluar me Prokurorin.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëmëngjesi, i nderuar Gjykatës. Josh Hafetz në emër të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, bashkë me mua janë kolegët e mi Julie Mann, Claire O'Connell, Brent Hicks dhe Dirk-Jan Laman.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Tani i drejtohem Mbrojtjes sipas renditjes në aktakuzë.

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Unë jam Mbrojtëse e Specializuar për Hashim Thaçin, quhem Sophie Menegon. Bashkë

me mua është z. Lirim Greicevci dhe znj. Lea Allix-Cornelissen dhe znj. Lisa Clemens. Faleminderit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Rees.

Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë jam Jonathan Elystan Rees, avokat në Mbretërinë e Bashkuar. Përfaqësoj --

Pikë së pari dua, fillimisht dua t'ju informoj, i nderuar, se për shkak të angazhimeve të tjera, më duhet të largohem nga seanca pas një ore. Por z. Bowden, që është bashkëmbrojtës, është i informuar për këtë dhe do të paraqesë, do të përfaqësojë interesat e klientit gjatë seancës, pjesës që ngelet.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit. Jam i informuar për këtë, z. Rees.

z. Edwards.

Z. EDWARDS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Përfaqësoj Isni Kilajn, në anën time të djathtë kam Eva Kalb, Joe Holms dhe përmes videolidhjes, Omar Soliman. Faleminderit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Young.

Z. YOUNG: [Përkthim] Mirëmëngjesi, i nderuar Gjykatës. Unë përfaqësoj z. Fadil Fazliu sot në mëngjes. Bashkë me mua këtu, në anën time të majtë, është znj. Yuqing Liu.

Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës. Unë quhem Alexander Admiraal, Mbrojtësi i Specializuar dhe

përfaqësoj këtu z. Kuçi.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull.

Mund të prezantohen tani përfaqësuesit e Zyrës Administrative.

[Nuk ka përkthim].

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit të gjithëve për prezantimin, për praninë tuaj dhe të akuzuarve që janë të pranishëm në sallën e gjyqit në veçanti.

Unë jam Christopher, Gjykatësi i vetëm në këtë çështje. Jam si Gjykatës i vetëm në këtë çështje në pajtim me nenin 15(2) të ligjit mbi Dhomat e Specializuara, që e lejon këtë gjë kur bëhet fjalë për vepra penale që nuk cilësohen si krime të rënda sipas nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Më 12 nëntor 2025, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ma kaloi dosjen e kësaj lënde, kësaj çështjeje mua.

Më 17 nëntor 2025, siç kërkohet nga rregulla 116(2), nxora kalendarin për seancën e sotme duke kërkuar parashtrime nga palët për disa pika të caktuara që janë relevante për përgatitjen e fillimin e procedurës gjyqësore në këtë çështje. Në këtë urdhër, që është parashtrimi 549, thashë se do të përdorja kompetencën time për të kombinuar seancën për përgatitjen e gjykimit sipas rregullës 117 dhe seancës për përgatitjen e ZPS-së sipas rregullës 118 për t’i bashkuar këtu në një konferencë të vetme, pra, një seancë të vetme që do të

ndodhte sot. Konstatoj se ZPS-ja në parashtrimet e saj, në parashtrimin 559, ka kërkuar që këto dy seanca të veçohen që me sa shoh është kërkesë për të rivlerësuar vendimin tim.

Këtë vendim lidhur me këtë kërkesë do ta marrë në fund të seancës së sotme, por do të shtoja që tani se pavarësisht se si cilësohet apo klasifikohet kjo seancë, nuk do të hezitoj të caktojë seancat e tjera për ecurinë dhe për përgatitjen e çështjes sipas kërkesës së ZPS-së në raste kur duhet të jetë e nevojshme për përgatitjen e gjykimit dhe klasifikimit të seancës së sotme dhe klasifikimi i seancës së sotme nuk do të përcaktojë fillimin e datës së gjykimit.

Përpara se të fillojmë, do t'ju kujtoja të gjithëve që marrin pjesë sot dhe ndërhyjnë, kryesisht duke pasur parasysh numrin e madh të njerëzve që bashkëndajnë të njëjtën gjuhë amtare, që të flasim në ritëm të arsyeshëm dhe të mos flasim njëkohësisht. Në këtë mënyrë ju japim mundësinë përkthyesve dhe stenografëve që të bëjnë punën e tyre që është shumë e rëndësishme për t'u siguruar që të akuzuarit të kuptojnë tërësisht gjithçka që thuhet në seancë.

Ju lutem, përpiquni të formuloni parashtrimet tuaja në një mënyrë që shmang mundësinë, detyrimin për të kaluar në seancë private, po natyrisht, në qoftë se është e nevojshme që duhet t'u referoheni dokumenteve apo informacioneve konfidenciale, natyrisht do të kalojmë në seancë private për këtë qëllim.

Seanca e sotme do të fillojë -- sa i përket seancës së sotme do të vazhdojmë deri në orën 11.00, pastaj do të bëjmë një gjysëm ore pushim dhe do të vazhdojmë deri në orën 1.00. Pastaj në qoftë se ka nevojë do të bëjmë edhe një seancë pasdite nga ora 2.30 deri në orën 4.00.

Dua të falënderoj të gjitha palët për parashtrimet e tyre shumë të dobishme në kuadër të përgatitjes së seancës së sotme që e zvogëlon në mënyrë të konsiderueshme numrin e temave që duhet të diskutojmë sot gjatë seancës së sotme dhe na ndihmon në qartësimin e disa pikave të mospajtimit apo mospërputhjes, qëndrimet mospërputhëse të palëve.

Propozoj që të vazhdojmë më tej duke ju bërë palëve disa pyetje që dalin, burojnë nga këtë parashtrime dhe në fund në qoftë se dikush dëshiron të ngrejë çështje të caktuara relevante për përgatitjen e gjykimit, atëherë mund ta bëjnë këtë gjë. Natyrisht, duke patur parasysh që nuk ka nevojë që të përsërisim parashtrimet që janë bërë me shkrim.

Pra, dua të filloj me një temë ku duket që ka një pajtim apo qëndrime të përbashkëta, pikëpamje të përbashkëta, kjo ka të bëjë me mocionin për provat jogojore. Po do të doja që të ndaj, të filloj me diskutimin sot, pra, për një temë që duket që ka një lloj marrëveshjeje. Dhe konstatoj që të dy Prokuroria dhe Mbrojtja e Thaçit, të paktën, duket sikur kanë të njëjtën pikëpamje lidhur me këtë mocion që duhet të paraqitet dhe të dorëzohet përpara fillimit të gjykimit.

Lexoj se Prokuroria është e përgatitur ta paraqesë këtë mocion gjatë javës së 15 dhjetorit 2025.

Konstatoj gjithashtu se z. Thaçi nuk ka kundërshtuar afatin kohor për parashtrimin e mocionit por kërkon që kalendari apo planifikimi të përshtatet me qëllim që Mbrojtja të ketë kohë të mjaftueshme për t'u përgjigjur, përfshirë duke pezulluar afatet për përgjigjet dhe kundërpërgjigjet gjatë periudhës së pushimit dimëror. Kjo është në paragrafin 22 të parashtrimit 568.

E kam konsultuar kalendarin dhe konstatoj se kjo i bie që të krijohet një periudhë 40 ditore për t'u përgjigjur, duke supozuar se mocioni për provat jogojore dorëzohet më 15 dhjetor. A mund të komentoni lidhur me këtë, znj. Menegon, nevoja për një zgjatje të periudhës me qëllim për t'ju përgjigjur mocionit të Prokurorisë?

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar. Shqetësimi që unë kisha nuk ishte -- varet nga numri i materialeve që do të dorëzohen me shkrim, varet nga çështjet ligjore që do të ngrihen dhe mund të kemi nevojë për më shumë kohë. Në këtë fazë, nuk jam e sigurtë për numrin e materialeve që do të paraqiten dhe dua të rezervoj qëndrimin tonë lidhur me këtë. Nuk jam e sigurtë që do kemi absolutisht nevojë për një zgjatje të tillë, por mund të ndodhë kjo gjë, pra, kjo varet nga numri i materialeve që do të marrim përmes këtij mocioni nga Prokuroria dhe mund të kërkojmë një zgjatje.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, znj. Menegon.

Besoj që z. Thaçi ngriti dorën.

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Është e vërtetë, në fakt, ai më tha që donte të bënte një koment të shkurtër. Nuk e di në qoftë se do t'ia jepni fjalën tani. Nuk është e lidhur drejtpërdrejt me çështjen e kalendarit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju sugjeroj që të vazhdojmë me agjendën dhe pastaj z. Thaçi do t'i jepet mundësia të bëjë një ndërhyrje në fund të seancës së sotme.

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Prokuroria ka ndonjë koment lidhur me natyrën e mocionit për prova jo gojore, lidhur më kohën për përgjigjet?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës. Ne ia lemë Gjykatës që të vendosë afatin kohor për përgjigjet. Ajo që dua të them dhe që mund të them është që ndonëse do të ketë një numër të konsiderueshëm materialesh që do të dorëzohen përmes mocionit për prova jogojore që ne i kemi parashikuar tashmë apo mocionet e tjera për pranim provash me shkrim, kategoritë janë të pakta, të veçuara dhe të ditura, pra, po them thjesht që numri nuk ndihmon. Mund të jenë 200 dokumente, dokumente me shkrim nga qendra e paraburgimit dhe për të gjitha ka një bazë, pra, një justifikim ligjor për t'u paraqitur dhe ato kanë një qëllim dhe është i njëjti, pra, për sa i takon nevojave për të vendosur mbi mocionin. Pra, unë mendoj që i

kemi bërë dy kategori, i kemi përfshirë të gjitha ato në dy kategori dhe ne e kemi dorëzuar këtë përmes parashtrimit. Pra, është shumë transparente.

Dhe do të thoja gjithashtu që kemi patur diskutime me palët e tjera që janë shumë të dobishëm dhe falënderoj të gjitha palët për këtë në një përpjekje për të zvogëluar, për të ngushtuar këto kategori dhe për të arritur në një marrëveshje për njërën apo për të dyja prej këtyre kategorive. Do vazhdojmë duke bërë këtë gjë. Natyrisht është vendimi juaj, i nderuar Gjykatës, për të pranuar edhe në rastet kur ka mosmarrëveshje, por ka disa prej këtyre për të cilat jemi pajtuar dhe jemi në gjendje që t'ua prezantojmë juve.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Hafetz, a kuptoj se ju po planifikoni që të paraqisni një mocion për prova jogojore që është i ngjashëm në formë me mocionin për prova jogojore që janë paraqitur nga ZPS-ja në çështjet e tjera?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Po.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ekipet e tjera të Mbrojtjes a kanë komente lidhur me paraqitjen, dorëzimin e mocionit për pranim të provave jo gojore, pra, përpara fillimit të gjykimit dhe afatet për përgjigjet e tyre?

Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] I nderuar, Prokuroria në qoftë se duan të bëjnë një kërkesë të kësaj natyre, duhet ta bëjnë atë sa më shpejt që është e mundur. Koha që na duhet për t'u përgjigjur është -- e kemi dhënë këtë

në parashtrimet tona dhe kjo do të marrë përgjigje më të qartë në momentin që Prokuroria e bën këtë kërkesë, pra, një kërkesë të tillë. Dhe pastaj mund të shohim dhe të vlerësojmë se çfarë ka brenda, mund të vlerësojmë nivelin apo shkallën e pikave që mund të jenë kontroverse për të cilat nuk pajtohemi dhe shkallën në cilën ju, i nderuar Gjykatës, do të përcaktoni pjesërisht apo në tërësi lidhur me to.

Neve na duket që mënyra më e mirë për të ecur më tej do të ishte që të vendoset një kalendar strikt, afate të caktuara strikte për Prokurorinë që të bëjë kërkesa të tilla dhe jo vetëm që t'u kërkohet atyre që të paraqesin bazën mbi të cilën kërkojnë pranueshmërinë e këtyre dokumenteve përmes mocioneve dhe pastaj ju ta vlerësoni atë. Kjo mund të bëhet me shkrim ose përmes një konference për ecurinë e çështjes, mund të bëjmë parashtrime në momentin e duhur sa i takon rendit dhe afateve për t'u përgjigjur, sepse, siç e dini, ka pjesë të saj që nuk kanë nevojë që të trajtohen menjëherë. Dhe ka pjesë të tjera që duhet të trajtohen.

Pra, kjo është mënyra më e mirë për të vazhduar më tej. Mendoj që të gjithë këtu, përfshirë edhe juve, kryesisht juve, i nderuar Gjykatës, do të ndihmoheshit nga Prokuroria në qoftë se ju i kërkoni atyre që të bëjnë këto kërkesa sepse janë të domosdoshme për të përgatitur, atë që ata mendojnë janë të domosdoshme për përgatitjen e paraqitjes së çështjes së tyre në gjykim. Në momentin që ne do t'i marrim, do shohim që

mënyrën më e mitë për t'i trajtuar ato.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Ndonjë koment nga Mbrojtjet e tjera.

Z. EDWARDS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Thjesht desha të qartësoj. Mendoj që ju përmendët një afat 40 ditorë për t'u përgjigjur. Por shoh që parashtrimi mund të bëhet më 15 dhjetor dhe do të doja që të kishim mundësi të përgjigjeshim, që i bie që ne do të duhet të përgjigjeshim më 25 dhjetor dhe po mendoja të kërkonim një zgjatje, për shembull, deri në javën e parë të janarit, për shembull, 5 janar do të ishte shumë më pak se 40 ditë. Faleminderit.

Thjesht dua të theksoj se pajtohem me kolegun tim, z. Rees, se mund të kërkojmë një zgjatje. Kur në momentin që të marrim kërkesën e tillë do të shohim mënyrën më të thjeshtë për ta trajtuar atë.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Ndonjë kërkesë, parashtrim tjetër? Z. Young?

Z. YOUNG: [Përkthim] Jo.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ne në momentin e duhur do të nxjerrim kalendarin ku merret me këtë pikësëpari dhe kjo do të vendoset ose sot ose jo më vonë se të hënën, sa për t'ju informuar.

Tani po kaloj tek çështja e dëshmitarëve, dëshmitarët që do të japin provat që janë dëshmi dhe që do të dëgjohen në

këtë rast, në këtë çështje. Dhe falënderoj palët për qasjen e tyre konstruktive dhe pjesëmarrjen e tyre konstruktive në disa çështje shumë konkrete dhe për vlerësimet që kanë të bëjnë me kohën që duhet me dëshmitarët.

Prokuroria, konstatoi, ka paraqitur çështjen e tyre, pra, provat kryesore, mendojnë ata, nuk do të zgjasin më shumë se dy javë për të paraqitur të gjithë provat e tyre dhe propozon që të gjithë dëshmitarët të dëgjohen në mënyrë të njëpasnjëshme në fillim të shkurtit. Dhe meqenëse kohëzgjatja e dëshmitarëve në këtë çështje mund të ketë ndikim në datën që do të caktohet për fillimin e gjykimit, desha të sigurohem që ne kemi një kuptim sa më të qartë që është e mundur për kohëzgjatjen që mund të presim, kohën që presim që duhet për të marrë në pyetje secilin prej këtyre dëshmitarëve.

Tani, sa i takon Dëshmitarit 7, konstatoj se Prokuroria ka konfirmuar se ata kanë paraqitur, sipas rregullës 154 të Rregullores, tre dokumentet që janë nxjerrë më herët dhe dëshminë e tij kryesore, deklaratën e tij.

A mund të qartësoj nëse Prokuroria ka në mend që mund të ketë ndonjë mundësi që dëshmia kryesore, jo çështja e marrjes në pyetje, jo marrja në pyetje nga pala e kundër, pra, nga Mbrojtja, por dëshmia që do të jepet për Prokurorinë mund të ndikohet nga më tej nga rezultatet e hetimeve që janë akoma në vazhdim e sipër?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Mund të ketë ndikim në këtë. Është

e vështirë të themi derisa të përfundojë dhe të marrim rezultatet e hetimeve. Është e mundur që mund të ndikojë në të, po flasim për orë, një dëshmi që do të zgjasë me orë, por për hollësi të mëtejshme do t'i kemi më vonë varësisht nga rezultati i hetimeve. Dhe nuk mund t'ju përgjigjem tani.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A pritet që fushëveprimi apo pjesë të tjera shtesë të dëshmisë së tij të jenë të kufizuara që të themi që këto mund të trajtohen në mënyrë gojore, po keni synimin që të përgatitni ndonjë deklaratë tjetër shtesë dhe ta paraqisni atë si deklaratë, pra, në atë mënyrë?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Edhe në këtë rast është e mundur që mund të kërkojmë një dokument. Është thjesht e pamundur që ta themi tani, nuk mund të parashikojmë.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Sepse në pamje të parë duket nga deklaratat që kemi tani se dëshmia e dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë është gjithëpërfshirëse, i përfshin të gjitha çështjet, përfshirë edhe hetimet që janë në zhvillim e sipër. Pa hyrë në hollësi të mëtejshme që duhet të na kërkonte të kalojmë në seancë private, thjesht doja të dija se cila është çështja apo tema që mund të trajtojë dëshmia shtesë, pjesa shtesë e dëshmisë së Dëshmitarit 7.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Ajo që mund të them, i nderuar Gjykatës, në seancë të hapur është që mendoj që mund të kalojmë në seancë publike për të trajtuar këtë pikë. Por ajo

që mund të them është informacionet shtesë që mund të vijnë përmes deklaratës me shkrim për këtë dëshmitar, me fjalë të tjera, pra, një dokument shtesë, një deklaratë shtesë do të ishte shumë e kufizuar në fushëveprim dhe qëllimet, synimet e tij, pra, do të ishte natyra e gjërave, do të bëhej fjalë për natyrën e gjërave të cilat janë tashmë të përshkruara në deklaratën tjetër.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Dhe shoh nga dosja juaj paraprake se ju vlerësoni se koha që ju nevojitet për të marrë në pyetje dëshmitarin është dy orë. Dhe pas këtij parashtrimi është -- dhe kjo është bërë pas parashtrimit për dëshmi të drejtpërdrejtë ju do të paraqisni një në formë të shkruar, pra, pas dëshmisë dhënë në gjyq. A do të thotë kjo që koha që ju vlerësoni për marrjen në pyetje në sallë të gjyqit është më e shkurtër apo më e gjatë?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo detyrimisht. Kjo varet nga rezultati i mocionit sipas rregullës 154, nëse pranohet apo jo dhe mund të ketë materiale shtesë për të cilat nevojiten të trajtohen dhe që janë jashtë fushëveprimit të deklaratës së plotë.

Pra, disa prej -- pjesa tjetër, gjëja tjetër që desha të trajtoj sepse janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ju, i nderuar Gjykatës, e ngritët këtë gjë për çështjet dhe provat e Prokurorisë varen nga vendimi që merret për mocioneve, për pranimin e provave jo gojore për të cilat po

flasim. Dhe kjo, natyrisht, është situatë normale.

Pra, në parashtrimet e tyre, të paktën Mbrojtja e Thaçit, duket sikur pajtohet me neve edhe këtu vendimi lidhur me ato mocione do të jetë shumë i rëndësishëm dhe i nevojshëm për parashikimin e kohëzgjatjes së gjykimit që ta bëjmë atë në një mënyrë sa më të rregullt. Dhe kjo është pjesë e asaj që theksova, pra, sesa e rëndësishme është që t'i paraqesim këto gjëra përpara jush.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A kanë Ekipet e Mbrojtjes diçka për të thënë apo për të komentuar lidhur me kohën që u duhet atyre për marrjen në pyetje të Dëshmitarit 7?

Lidhur me këtë, z. Rees, që të jemi të qartë, parashtrimet -- ju falënderoj, z. Rees që keni qenë shumë i qartë në parashtrimet tuaja me shkrim në dosjen paraprake. Do të doja të pyes Ekipet e tjera të Mbrojtjes në qoftë se kanë ndonjë qëndrim për të shprehur lidhur me këtë pikë?

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Siç e kemi thënë, ne synojmë ta marrim në pyetje atë dëshmitar. Faleminderit.

Z. EDWARDS: [Përkthim] Edhe ne synojmë ta marrim, t'i bëjmë pyetje atij. Dhe do të jetë një marrje në pyetje që nuk do të jetë shumë e gjatë, e kam gjithmonë të vështirë dhe hezitoj që të them saktësisht kohën që do të duhet, po sigurisht brenda një seance gjyqësore.

Edhe nëse më lejohet, meqenëse jam këtu, dua të bëj një koment, sepse kolegu im nga ZPS-ja sapo tha se pavarësisht tre

deklaratave të plota të dhëna nga Dëshmitari 7 mund të ketë dëshmi të tjera shtesë gojore që lidhen me materiale shtesë që janë jashtë fushëveprimit të këtyre tre deklaratave. Po gjërat që nuk janë përfshirë në këto deklarata dhe mu kujtua, në qoftë se ndodh kështu, ZPS-ja ka kohën që ta zvogëlojë informacionin shtesë me shkrim, në një deklaratë të katërt, e cila mund të shkurtonte, pra, dhënien e dëshmisë në Gjykatë të dëshmitarit në shumë pak gjëra dhe kjo do t'ju ndihmonte edhe juve, i nderuar Gjykatës edhe Ekipet e Mbrojtjes, për të trajtuar këtë material shtesë.

Thjesht e ngrita këtë sepse është diçka që ZPS-ja mund ta marrë parasysh dhe mund të jetë diçka që ju, i nderuar Gjykatës, mund të dëshironi ta merrni parasysh dhe të nxirrni një urdhër lidhur me këtë.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit. Dhe sa për të shtuar, kjo është një çështje për të cilën kemi patur diskutime mes palëve dhe do të ishte shumë e dobishme që të arrijmë në një marrëveshje lidhur me këtë pikë në veçanti.

Z. Young.

Z. YOUNG: [Përkthim] Faleminderit. Qëndrimi jonë është që ne, sigurisht, që duam t'i bëjmë pyetje Dëshmitarit 7, por nuk presim që të marrim më shumë se një orë apo dy lidhur me çështje të ndryshme.

Sa i takon çështjes së dëshmisë së dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ky gjykim përmban, do të trajtojë shumë

dokumente dhe shumë pak dëshmitarë. Dhe ne shohim që Prokuroria duket se po sugjeron se ata duan të mbështeten në tre dëshmitarë. Dhe do t'ju kërkoja sot dhe palët që të marrin parasysh një lloj rendi. Shpresoj që diskutimet mes palëve që kemi patur na kanë dhënë një ide të rendit të mundshëm të paraqitjes së dëshmitarëve. Dhe do të isha shumë falënderues që të na tregohet, të informohemi paraprakisht përpara gjykimit mbi rendin e paraqitjes së dëshmitarëve.

Dhe kam një pikë tjetër që do ta trajtoj pak më vonë lidhur me politikën e thirrjes së dëshmitarëve nga Prokuroria, pra, ata mënyrën sesi e bëjnë, metodën e tyre.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Admiraal.

Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Faleminderit. Varet nga rezultati i hetimeve që janë në vazhdim e sipër të pakryer akoma.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë e kam shprehur qëndrimin tim lidhur me Dëshmitarin 7. Megjithatë, dua të ngre diçka që është shqetësim për mua dhe kjo del drejtpërdrejt nga diçka që z. Hafetz, Prokurori, tha lidhur në emër të diskutimeve që kemi patur që, në fakt, ishin shumë të dobishme nga të dy palët.

Z. Hafetz e pranon se të gjithë do të ishim shumë më mirë të informuar që të merreshim me çështjet e përgatitjes së gjykimit, për shembull, ZPS-ja ka dhënë paraprakisht para

datës së sotme ka informuar për kërkesat e tyre për të pranuar dokumente e materiale, prova materiale shkresore, përveç atyre që pranon përmes dëshmitarit dhe ata do të bëjnë një mocion për pranim të provave jogojore, që sipas tyre është baza për pranueshmërinë e këtij materiali. Pajtohem me këtë.

Gjithashtu vërej se lidhur me këto çështje ka 12 muaj, pra, që Prokuroria do të kishte kohë dhe do të duhet të ishte përgatitur për gjykim tanimë. Kjo është arsyeja pse e përsëris, së pari, se dua që Prokurorisë t'i jepen afate shumë të shkurtra për të paraqitur kërkesat e hollësishme dhe të detajuara për paraqitjen e provave përmes rrugës së zakonshme, pra, dëshmitarit që paraqitet në sallë dhe kjo të bëhet në mënyrë të menjëhershme.

Së dyti, diskutimi lidhur me Dëshmitarin 7 duket se bazohet të paktën, sa i për ketë Prokurorisë, në faktin se e gjithë gjëja po lëviz e po ecën në mënyrë të shpejtë dhe jo se ata kanë diçka për të nxjerrë apo prova, dëshmi për të nxjerrë nga Dëshmitari 7, por kjo varet nga vazhdimi i hetimeve dhe rezultati i tyre. Tani kjo nuk është shumë e saktë sepse çdo përpjekje në kohë të duhur, pra, kur të vijë për të nxjerrë dëshmi apo prova të mëtejshme duhet të vijë, duhet të shoqërohet me një shpjegim për arsyen, një shpjegim për fazën e vonuar të momentit kur bëhen këto.

Thjesht dua ta bëj të qartë sepse kjo na duket neve se ZPS-ja po punon mbi bazën e supozimit që koha e tyre është e

pakufizuar.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Tani kalojmë tek Dëshmitari 9. A mund të pyes Prokurorinë nëse e kanë nxjerrë deklaratat lidhur me këtë dëshmitar Mbrojtjes?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Ne kemi nxjerrë atë që mendojmë janë katër shënime zyrtare për këtë dëshmitar. Nuk janë deklarata në mënyrë formale, sepse nuk janë marrë nga një kontekst formal, por janë shënime zyrtare të tij dhe ku ai ka shënuar se si ka marrë prova nga pajisje elektronike dhe këto janë ato, ai është gati të japë dëshmi lidhur me këtë çështje. Dhe ai është dëshmitari tjetër sipas rregullës 154.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Tani i drejtohem Mbrojtjes, e kuptoj që tani flasim për vlerësime të përgjithshme, por dua të di prej jush, Mbrojtjes, qëllimin tuaj lidhur me bërjen pyetje të dëshmitarëve, sa mendoni se do të zgjasin këto pyetje?

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit. Jemi gati që bëjmë pyetje, por nuk mund t’ju them në këtë moment sesa kohë do të zgjasin ato.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Rees. Z. Rees, nuk e di më dëgjoni?

Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Qëndrimi ynë është i njëjtë me atë të znj. Menegon.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Edwards?

Z. EDWARDS: [Përkthim] Edhe ne kemi të njëjtin qëndrim.

Z. YOUNG: [Përkthim] Gjithashtu dhe ne.

Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Të njëjtin, po në vartësi të hetimeve.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Tani vijmë te Dëshmitari 8. E kuptoj që janë bërë, janë nxjerrë disa materiale lidhur me këtë dëshmitar. Por a mund të konfirmojmë nëse ndonjë prej nxjerrjeve të materialeve, duke përfshirë deklaratën, a përbëjmë ato raportin ekspert, dhe kur Prokuroria synon ta paraqesë këtë si raport eksperti?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit. Raporti ekspert nuk është deklarata. Ajo ishte për të sqaruar raportin. Ne e kemi nxjerrë raportin e ekspertit me datë 14 dhjetor 2024, dhe do ta paraqesim me shkrim me letër, pra, por do ta përdorim, pra, në pyetjet tona.

E kuptoj që Mbrojtja e z. Thaçi, ka kërkuar dokumentacion shtesë të cilin ne do t'jua japim në bazë të rregullit 102(3) të hënën në bazë të pyetjeve bazë të cilat shpuan, u bënë shkak për këtë raport, por besoj pra, do tua japim të hënën.

Por për qëllimet tona ose raporti ndërkohë i nxjerrë apo lista e dëshmitarëve me qëllim që të do të dëshmojnë si ekspertë ka bërë, ka vënë në lëvizje, pra, kërkesën 149.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] E kuptoj.

ERN 118299 deri 118304, pra, ju lutem konfirmojeni,

kontrollojeni dhe një herë dhe konfirmoni që është apo jo raporti eksperti i cili po paraqitet në bazë të 149(1).

Ka ndonjë pyetjet ekipet e Mbrojtjes lidhur me këtë dëshmitar, a janë në gjendje të na japin ndonjë vlerësim lidhur me pyetjet -- kohën që do të kërkojnë pyetjet e tyre? E di që dosja paraprake e z. Thaçi lidhur me çështjen e printimit të shtypur dhe kjo provokon pyetjen, pra, nëse keni ndërmend t'i bëni pyetje këtij dëshmitari dhe nëse po, sa kohë do t'ju duhet?

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po, do t'i bëjmë pyetje, por nuk ju jap dot një vlerësim për kohën që do të na duhet.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Rees.

Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Edhe ne kemi të njëjtën qëndrim.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Kjo vlen për të gjithë ekipet e Mbrojtjes? Nëse jo, mund të shpreheni?

Z. EDWARDS: [Përkthim] Po, ky është qëndrimi ynë. Kolegu i nderuar i ZPS-së para një momenti tha që kemi kërkuar dokumentacion shtesë që lidhet me raportin e ekspertit. Më duket se bëhet fjalë për nëntë apo dhjetë dokumenteve të tjera. Në vartësi të rezultatit të kërkesës sonë për prova shtesë, kjo do të ndikonte në vlerësimin tonë të kohës që do të na duhet për t'i bërë pyetje. Por në këtë moment, po e përsëri, nuk e dimë sa do të zgjasin këto pyetje.

Z. YOUNG: [Përkthim] A mund të them që mbase nuk ka shumë

gjasa që nuk do të kemi pyetje për Dëshmitarin 8, por nëse kemi, kemi të njëjtën pozicion, qëndrim.

Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Njëlloj si më parë.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Kur thoni "njëlloj si më parë", e keni fjalën për të njëjtin qëndrim se Dëshmitari 7 apo si tha z. Young?

Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Jo, njëlloj si për Dëshmitarin 7.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Në qoftë se mundet, kam diçka.

Faleminderit, z. Edwards që e ngriti këtë çështje. Dje morëm 102(3), kërkesa që ai përmendi, do t'i rishikojmë në momentin e duhur.

Nuk dua t'ju heq vëmendjen, po meqë po flasim për rregullin 149, dhe raportin e ekspertit një apo disa prej ekipeve të mbrojtjes mund të kërkojnë ekspertët e tyre dhe mund të lidhen me këtë, me të njëjtën temë, pra, me printimin. Në qoftë se ndodh kështu, në bazë të rregullit 149, ju kërkojnë, I nderuar Gjykatës, të përcaktoni një datë të arsyeshme pasi të merrni raportin e Mbrojtjes, nëse do të ketë. Nuk e themi dot dy ditë dy ditë përpara se të vijë eksperti, duhet ta dimë përpara.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po thoni që këto raporte duhet të vijnë përpara paraqitjes së dëshmitarit?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, por them se nuk kemi datë dhe nuk e dimë sa raporte mund të ketë nga ana e Mbrojtjes.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Nuk është fundi i dëshmitarëve të mundshëm të Prokurorisë, sepse ka një mocion apo të paktën një kërkesë të Smakajt, në dosjen paraprake të Smakajt se Prokuroria mund të jetë e detyruar të thërrasë një dëshmitar të caktuar.

Pa u futur në këtë moment, pa diskutuar themelin e një kërkese të tillë, dua së pari, të mësoj qëndrimin e Prokurorisë për këtë kërkesë.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Ne mbështetmi në rastin që nuk jemi të detyruar që ta thërrasim atë dëshmitar, dhe tani që po flasim, nuk kemi ndërmend ta thërrasim.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Rees, pa e diskutuar çështjen këtu në këtë Konferencë për Ecurinë e Çështjes, çfarë mendoni ju për këto që sapo tha Prokuroria?

Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Kjo është hera e parë që Prokuroria e vë në dukje këtë lloj qëndrimi. Jam mirënjohës. Ne do të diskutojmë, do të mendohemi mbasi të diskutojmë do të bëjmë atë që na duhet, që duket e përshtatshme.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Tani i kthehem, në fakt, variablës së rëndësishme që ka të bëjë me fillimin çështjes, që është çështje e hetime të vazhdueshme -- që po vazhdojnë, të Prokurorisë. Kam një numër pyetjesh të cilat dua t’ja drejtoj Prokurorisë, në radhë të parë. Dhe pasi t'i kemi diskutuar këto pyetje, do t'i kërkoj

Mbrojtjes të komentojnë për përgjigjet që do të japë Prokuroria.

Vërej se në parashtrimin e Prokurorisë 559, qëndrimi i ZPS-së është që gjyqi nuk mund të fillojë, dhe këtu citoj nga paragrafi 3, "pasi të kenë përfunduar, përpara se të kenë përfunduar hapat e mbetura hetimore". Dhe pastaj ju thoni në paragrafin 3 që gjykimi mund të fillojë në fillim të shkurtit 2026. Vërej gjithashtu se vlerësimi juaj se kur hetimet mund të përfundojnë, dhe këtu citoj nga paragrafi 7 i parashtrimit tuaj, "varet se kur ZPS-ja do të marrë materialet" nga një ofrues i jashtëm shërbimesh dhe se atëherë mund të ketë, dhe citoj prapë, "mund të ketë hetime të mëtejshme në vijim". Pastaj ju përmendni një hap hetimor në paragrafin 20 i cili do të fillojë në "shkurt 2026". Dhe nga dokumentet e tjera të paraqitura nga Administratori dimë se ofruesi i jashtëm na ka thënë se data e dorëzimit do të përfundojë kur të fillojë puna në janar 2025.

Pra, dua të kuptoj natyrën e parashtrimit tuaj sipas të cilit gjykimi mund të fillojë në fillimin të shkurtit. A jeni duket thënë, z. Hafetz, se jeni gati të filloni gjykimin në fillim të shkurtit sido që të vijë puna? Apo po thoni se varet nga statusi i hetimeve ashtu siç mund të jetë ai në fillim të shkurtit?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit. Së pari, t'i përgjigjem pyetjes që bëtë më parë. Juve thatë të drejtë -- e

cituat drejtë ERN, data e raportit është 14 dhjetor. Ju e thatë saktë.

Përgjigja e pyetjes suaj është kështu: Varet pak nga rezultati përfundimtar dhe zgjidhja e këtyre hapave që janë akoma në vijim e sipër. Dy janë zgjedhur -- janë zgjidhur në dy ditët e fundit. Me kënaqësi mund të them atë që është me rëndësi. Përveç një kërkese për sqarim që nuk e kemi zgjidhur, lidhur me një numër metadash, dhe kjo nuk do të zgjasi shumë, na kërkohet dhe pak informacion, ndryshe të gjithë hetimet që kemi parashikuar me 1 gusht [Sipas përkthimit] janë në përfundim e sipër. Nga ajo që mund të themi, nga puna që po bëjnë palët e jashtme nuk do të zgjasi më shumë mesi i janarit.

Disa prej materialeve duhen përkthyer dhe duhen analizuar dhe vlerësuar për rëndësinë e tyre dhe të nxirren sa më shpejt që të jetë e mundur të gjitha palëve. Dhe pastaj mund të formulojmë kërkesa që këto materiale t'ja shtojmë provave, listës sonë të provave materiale.

Nuk është një, të themi, hetim i pafund, është i synuar për gjëra specifike të cilat kemi kërkuar dhe të gjitha janë pjesë e kësaj çështje dhe bëhet fjalë për ndonjë hetim tjetër.

ZPS-ja ka ngushtuar objektin e hetimit për t'u përqendruar në provat më me rëndësi që duket se ne kërkojmë.

Gjithashtu, duhet të vë në dukje, dhe faleminderit që më dhatë fjalën, vonesa për cilën flasim është vënë në lëvizje

për shkak të dy sistemeve të cilët të dy, sipas përkufizimit, përmbajnë informacion mundësisht të privilegjuar. Po të kishim pas mundësi t'i bënim vetë, do të kishte zgjatur më pak gjithë kjo punë. Po kjo është arsyeja e vonesës.

Ne presim që këto hapa të përfundojnë në mes të janarit. Ka mundësi, ka gjasa që një nga hapat, në veçanti, mund të kërkojë një ndjekje të synuar dhe varet nga rezultati që do të kemi. Nuk flas dot tani për të.

Për sa i takon fillimit të gjykimit, dhe atë keni parasysh me pyetjen tuaj, duke pasur parasysh parashtrimet tona të Mbrojtjes, urdhrat që kanë dalë që nga atëherë, e kam shumë të qartë që materialin do ta kemi në mes të janarit dhe ndërkohë përpara apo mbrapa mund të kemi -- të ndjekim çështjen. Mbase mund ta ngushtojmë dhe më tepër dhe ta reduktojmë punën e palës së jashtme. Ajo që ka më kuptim, bazuar në parashtrimet e palëve, është që të kuptojmë provat që kemi dhe të kuptojmë që ajo që ne sugjerojmë do të jetë, pra, në mes apo në fund të shkurtit.

Pra, për sa i takon -- pyetja është, a do të na lejoni t'i përfundojmë të gjitha këto hapa dhe t'i kemi dëshmitë pastaj, t'i paraqesim këtu.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Shqetësimi që kam unë është se këto hetime nuk janë nën kontrollin, në një farë mase, të Gjykatës. Dhe siç ju e dini më mirë, mbase më mirë nga të gjithë, ka pasur vonesa dhe vlerësime jo të sakta lidhur me

hapat me shpejtësinë e hapave që do të përfundonin. Edhe në parashtrimin tuaj 420, ju keni thënë që 14 nëntori 2025 ishte një kohë e përshtatshme për kalimin e çështjes në fazën e hetimit.

Por siç e dini nga rregullorja, kjo do të përfshinte që gjykimi të fillonte brenda 60 ditëve, që i binte në mesin e janarit. Ky është vlerësimi që keni bërë në 25 gusht 2025, dhe siç shihet ka kaluar që nga ajo kohë, dhe ju e keni shtyrë gatishmërinë tuaj për të filluar gjykimin me tre javë.

Pra, çfarë ju bën tani të sigurt që nuk do të ketë, pra, vonesa të tjera?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Për këtë kërkoj që të futemi në seancë private që të flas pak më në hollësi për hapat e nevojshme.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Të kalojmë, ju lutem, në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Është e qartë nga dosjet gjyqësore që përkthimi dhe zbardhja do të jetë e rëndësishme për këtë çështje gjyqësore. Vërej që ka një udhëzim nga Zyra Administrative për mënyrën se si kontrollohet verifikimi i përkthimit me gojë dhe me shkrim. Është një urdhër i datës 30 maj 2019, mund ta kërkoni pra, 30 maj 2019, KSC-BD-14.

Keni parasysh këtë dokument sepse do t'ju duhet herë pas here të kuptoni se si duhet të bëni kërkesat për verifikim. Dhe ju lutem njihuni me këtë dokument sa më shpejt që të jetë e mundur. Dhe këto kërkesa të jenë sa më të kufizuara, nëse është e mundur, në mënyrë që të trajtohen në kohë. Dhe nëse ka probleme lidhur me përkthimet me shkrim, me gojë, verifikimet, ju lutem, njoftoni sa më shpejt Trupin Gjykues.

Mbrojtja e Smakajt ka thënë se as avokati kryesor as bashkëmbrojtësi nuk do të jenë të disponueshëm nga 27 marsi deri në qershor 2026. Ne do të diskutojmë edhe për kalendarin e paraqitjes së provave të Mbrojtjes. Sigurisht fillon Prokuroria me hapjen e çështjes, por pas Prokurorisë do të ketë diskutime. Sigurisht kjo nuk ka lidhje me rrëzimin e akuzave sipas rregullës 103, por do të kemi diskutime se kur do të fillojë Mbrojtja me dëshmitarët e vet apo me provat e veta. Sidoqoftë, z. Bowden, më duhet t'ju them që ka mundësi që Trupi Gjykues nuk do të tërhiqet për dy muaj dhe të bëjë një pushim deri në momentin që të jeni ju të disponueshëm.

Z. BOWDEN: [Përkthim] Sigurisht që ne po flasim ende teorikisht për momentin sepse ne nuk e dimë datat. Këto ishin angazhime profesionale për të cilat ne kishim rënë dakord përpara. Por sigurisht nëse lind nevoja ne do të përpiqemi t'i ndryshojmë. Por për momentin këto janë angazhime profesionale për të cilat unë dhe z. Rees i kishim organizuar më përpara. Do të flas me z. Rees, edhe nëse gjykoni që do ta ndryshojmë,

do të përpiqemi t'i ndryshojmë.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit. E kuptoj, e kuptoj dhe situatën ku jeni. Po kjo prandaj po them që është e rëndësishme që të fillojmë sa më herët me diskutimet sa i takon paraqitjes së provave prej Mbrojtjes. Kështu që do të përpiqemi që ta realizojmë këtë në kohë.

Na kanë ngelur dhe shtatë minuta përpara pushimit. Përpara se të bëjmë pushimin unë mund t'ju them që unë përfundova me pyetjet e mia për palët. S’i kam bërë asnjë pyetje Mbrojtjes, i kam lexuar parashtrimet e tyre lidhur me afatet dhe aspektet e ndryshe që duhet të trajtojnë në parashtrimet e tyre. Nuk ishte mungesë interesi nga ana ime, por është e parakohshme që të flas me Mbrojtjen në këtë moment.

Ka ndonjë gjë që palët duan ta diskutojnë me ne përpara pushimit?

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] E kuptoj që po flisni për kalendarin. Dua t'ju informoj se në Çështjen 06, Trupi Gjykues ka shtuar dy data për argumentet përmbyllës më 16 dhe 18 shkurt, çka do të thotë se ekipi ynë nuk do të jetë e disponueshëm këtë javë. Faleminderit.

Z. EDWARDS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, e kemi thënë dhe në parashtrimet tona si unë edhe bashkëmbrojtësi im nuk do të jemi të disponueshëm javën e 16 dhe 20 shkurtit të vitit tjetër sepse kemi angazhime të organizuara më përpara.

Z. YOUNG: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të thënë. Ne do t'i dorëzojmë parashtrimet sipas afatit që na keni dhënë edhe sigurisht do të presim të dorëzojë parashtrimet Mbrojtja e Thaçit.

Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A ka Prokuroria diçka të mëtutjeshme?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Vetëm diçka. Ju kur filluam seancën e sotme folët për afatet për Konferencën Përgatitore të Prokurorisë. Thjesht do të doja të kuptoja si lidhet kjo me rregullën 118(3), sa i takon fillimit të gjykimit. Kjo është për interesin tim personal.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Unë nuk do të nxjerr urdhër aktualisht, z. Hafetz, po siç e kuptoj unë ka disa afate dhe Gjykatësi i Vetëm të mund të vendosë afate. Pra, nëse ne e konsiderojmë këtë seancë një seancë të rregullës 118(3) në kuadër të kompetencave që kemi ne për të shtyrë afatet, kjo nuk do të thotë që gjykimi do të fillojë menjëherë brenda 30 ditësh. Besoj se këtë deshët të dinit?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Po.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Kemi kompetencë të ndryshojmë afatet. Dhe nëse nuk do ju miratohet kërkesa për ndryshim afatesh atëherë edhe në qoftë se unë mendoj se nuk duhet të fillojë gjykimi pas 30 ditësh, atëherë të jeni të sigurt që ne do të ushtrojmë autoritetin që kemi në mënyrë që

të fillojë gjykimi në kohën e duhur.

Z. Thaçi kishte diçka për të thënë? Z. Thaçi kishte diçka për të thënë, znj. Menegon?

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, donte të bënte një konstatim të shkurtër, kishte për të thënë.

Z. THAÇI: [Përmes videolidhjes] Faleminderit, i nderuari Gjyqtar. Mirëmëngjesi të gjithëve. E mirëpres mbajtjen e kësaj seance për këtë arsye dhe jam sot në këtë seancë sepse jam i përcaktuar për respektimin e shtetit ligjor.

Por, i nderuari z. Gjyqtar, është me interes që në këtë Gjykatë të mos ndodhin gjëra që nuk lejohen të ndodhin në shtetet tuaja përkatëse. Si çdo popull, edhe ne shqiptarët, kemi historinë, traditat dhe vlerat kombëtare dhe shtetërore. Mendoj se caktimi i kësaj seance pikërisht sot, me 28 nëntor, do të duhej evituar.

Mbajtja e kësaj seance pikërisht sot, me 28 nëntor, për mua dhe çdo shqiptar është befasi jo e mirë. I nderuari Gjyqtar, sot çdo shqiptar ka festë kombëtare, shtetërore dhe familjare sepse është festa e dinjitetit dhe e krenarisë kombëtare, ku si çdo popull i lirë në botë, feston edhe kujtoj. Sot, çdo familje shqiptare dhe institucion edhe i Kosovës edhe kujton edhe feston. Prandaj, mua nuk më mbetet tjetër veç t'i uroj shqiptarët për festën e 28 nëntorit, të festojnë bashkuar, krenarë dhe me dinjitet. Besoj që nëntorët e tjerë do të jemi bashkërisht. Faleminderit shumë.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Thaçi, për këto fjalë. Më duhet t'ju them që këtë datë e caktuam pasi u konsultuam me të gjitha palët, dhe asnjë kundërshtim nuk pati për këtë ditë për Konferencën mbi Ecurinë e Çështjes apo për Konferencën e Përgatitjes.

Gjykata do të tërhiqet tani, Trupi Gjykues - më fal, do të tërhiqet tani për 30 minuta e do të rikthehemi e do të nxjerrim një ose dy urdhra me gojë.

--- Pauza fillon në rone 10.59.

--- Seanca rifillon në orën 11.30

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në fillim të seancës nuk përmenda një hap procedural që ishte, në fakt, t'i kërkoja Sekretares së Gjykatës të konstatonte praninë e personave që marrin pjesë përmes videolidhjes.

Pra, z. Kuçi, dikush tjetër i pranishëm me të?

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, I nderuar Gjykatës, në vendndodhjes përmes videolidhjes është i pranishëm z. Kuçi, unë vetë, pra unë vetë, Sekretari i Gjykatës.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Tani Gjykata do të nxjerrë urdhrin për kalendarin për fillimin e gjykimit, do të dorëzohet gjithashtu në formë të shkruar në kohë të duhur. Fillimisht do të nxjerr një urdhër gojor duke pasur parasysh parashtrimet e bëra me gojë dhe me shkrim të palëve lidhur me një pikë të afateve, pra, të

kalendarit. Ky urdhri i parë gojor.

Prokuroria urdhërohet të dorëzojë mocionin për pranimin e provave jogojore, që të dorëzojë, pra, të gjitha provat që nuk janë dëshmi të paraqiten, që janë pjesë e provave të tyre përveç ato që bëhen përmes dëshmitarit, dhe kjo duhet të bëhet me 17 dhjetor -- jo më vonë se 17 dhjetor 2025.

Urdhri i dytë, afati për parashtrimin e ZPS-së 578, duke patur parasysh fushëveprimin shumë të kufizuar të tij, ndryshohet, pra, dhe vendoset me datën 1 dhjetor, e hënë, 1 dhjetor 2025. Nuk do të pranohen kundërpërgjigje lidhur me këtë.

Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen tuaj në këtë Konferencën për Ecurinë e Çështjes.

Dhe me këtë seanca përfundon.

--- Seanca mbyllet në orën 11.32